

PROBLEME DHE DISKUTIME

SHABAN DEMIRAJ

RRETH KLASIFIKIMIT TË FOLJEVE TË ZGJEDHIME

I

Siç dihet, çështja e klasifikimit të foljeve të zgjedhime nuk ka gjetur ende një zgjidhje të kënaqshme në gramatologjinë e gjuhës shqipe. Arësyeja kryesore për këtë do kërkuar në vetë vështirësitë, që paraqit sistemi foljor i shqipes, i cili gjatë zhvillimit historik ka pësuar ndryshime të mëdha të karakterit fonetik dhe gramatikor. Zgjidhjen e këtij problemi e ka vështirësuar edhe mungesa e kritereve të përbashkëta sa më racionale. Në gramatikat e gjuhës shqipe¹ janë ndjekur kritere të ndryshme për çështje të tilla si trajtimi i foljeve të parregullta, format themelore që vihen në bazë të klasifikimit në zgjedhime, numri i zgjedhimeve dhe i nëndarjeve të tyre etj.

Lidhur me trajtimin e foljeve të parregullta në gramatikat e konsultuara prej nesh për këtë qëllim vihen re qëndrime të ndryshme. Në gramatikën e Samiut nuk bëhet fjalë fare për folje të parregullta; po kështu edhe në ato të Majerit e të Pekmezit. Kurse në gramatikat e Xanonit, Vaigandit, Tasit, Sheperit, Xhuvanit, Myderrizit, Cipos, Elezi-Dodbibës dhe Demirajt foljet e parregullta veçohen nga të rregulltat. Por edhe nocioni «folje të parregullta» ndryshon nga një gramatikë në tjetrën². Qëndrime të ndryshme vihen re edhe në lidhje me format themelore, që vihen në bazë të klasifikimit në zgjedhime. Disa gramatika (si ato të Samiut, Xanonit, Tasit, G.M.)³ marrin si formë themelore atë të paskajores, kurse disa të tjera (si ato të Majerit, Pekmezit, Vaigandit, Cipos, Domit, Elezi-Dodbibës dhe Demirajt) marrin për bazë format e së tashmes (v.

1) Për këtë artikull, që paraqitet si bazë për një diskutim të gjerë, janë pasur parasysh këto vepra: K. Kristoforidhi, *Grammatikë tes albanikes glösses*, Konstandinopojë, 1882; Sami Frashëri, *Shkronjëtoje e gluhësë shqip*, Bukuresht, 1886; Gustav Meyer, *Kurzgefaste albanesische Grammatik*, Leipzig, 1888; Anton Xanoni, *Gramatika shqyp*, Shkodër, 1909; Gjergj Pekmezi, *Grammatik der albanesischen Sprache*, Wien, 1908; Gustav Weigand, *Albanesische Grammatik im südgegischen Dialekt*, Leipzig, 1913; G.M., *Gramatika e gjuhës shqipe*, Shkodër, 1916; Koço Tasi, *Gramatikë e gjuhës shqype*, Vlorë, 1923; Ilo Dilo Sheqeri, *Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe*, Vlorë, 1927; A. Xhuvani, *Libri i gjuhës shqipe*, pjesa e dytë, për klasët e nalta të fillores e të parat e qytetses, Tiranë, 1939; Osman Myderrizi, *Gramatika e re e shqipes*, Tiranë, 1944; Kostaq Cipo, *Gramatika shqipe*, Tiranë, 1949; Mahir Domi, *Morfologjia historike e shqipes* (konspekt-leksione), Tiranë, 1961; P. Elezi — L. Dodbiba, *Gramatika e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1959; Sh. Demiraj, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe* (dispensë), pj. I, Tiranë, 1961; Sh. Demiraj, *Gramatika e gjuhës shqipe*, pj. I, Morfologjia (tekst për shkollat pedagogjike), Tiranë, 1962.

2) Nuk e quajmë të nevojshme të japim hollësi këtu mbi këtë pikë dhe mbi dy pikat e tjera që ndjekin.

3) Samiu dhe Tasi marrin si paskajore format e tipit *punuar, bërë*, etj.

I njëjës) dhe të së kryerës së thjeshtë. Gramatika e Sheperit merr si bazë formën e së tashmes (v. I njëjës), kurse gramatika e Myderrizit mbështetet edhe në format e së tashmes edhe në ato të paskajores së tipit *me punue*.

Edhe numri i zgjedhimeve dhe i nëndarjevet të tyre ndryshon nga një gramatikë në tjetrën. Samiu dallon pesë zgjedhime. Majeri sipas kriterit diakronik, i veçon foljet në *-mi* nga foljet në *-o*, përkatësisht *-io*, dhe këto të fundit i ndan në dy zgjedhime me përkatësisht katër dhe dy nëndarje secili. Pekmezi ndjek gjurmët e Majerit në kriteret e klasifikimit, por foljet në *-o* i ndan në katër zgjedhime me nga dy nëndarje secili. Tasi dallon katër zgjedhime, kurse Sheperi pranon vetëm dy. Cipua ndjek Pekmezin duke pranuar, si ai, katër zgjedhime (me përkatësisht tri, dy, dy, dy klasa secili). Kriteret e Pekmezit ndjek edhe Domi, katër zgjedhime me nga dy klasa secili. Xhuvani pranon tre zgjedhime. Edhe Myderrizi pranon vetëm tre zgjedhime dhe për këto mbështetet pjesërisht në kriteret e Pekmezit. Edhe Elezi-Dodbiba dhe Demiraj, në vija të përgjithshme, mbështeten në kriteret e Pekmezit e të Cipos, por nuk pranojnë zgjedhimin e katërt, duke i trajtuar shumicën e foljevet të këtij zgjedhimi si të parregullta; ata ndryshojnë edhe në renditjen e tipave të zgjedhimit.

Shumica e gramatikave të shqipes për klasifikimin e foljevet në zgjedhime janë mbështetur në analizën sinkronike të sistemit foljor, kurse Majeri, Domi dhe pjesërisht edhe Pekmezi, Vaigandi, Cipua janë mbështetur në analizën diakronike.

II

Pas mendimit tonë, për klasifikimin e foljevet në zgjedhime duhen ndjekur këto kriteret:

1) Problemi duhet parë në planin thjesht sinkronik dhe si bazë duhet marrë shqipja e sotme letrare.

2) Një folje, që në fleksion paraqit parregullsi të tilla, të cilat nuk e lejojnë të grupohet me folje të tjera, duhet lënë jashtë klasifikimit në zgjedhime, duke u trajtuar si e parregullt. Këtu kemi parasysh jo vetëm foljet supletive, por edhe ato folje, temat e të cilave gjatë fleksionit pësojnë alternime tingujsh, që në shqipen e sotme paraqiten të izoluar. (Lista e foljevet të parregullta do të jepet në fund).

3) Për klasifikimin e foljevet në zgjedhime dhe nënzhgjedhime në shqipen e sotme, është më e arsyeshme dhe shkencërisht më e këshillueshme që të mbështetemi në një kriter të vetëm, ashtu siç veprohet zakonisht edhe për klasifikimin e emrave në lakime. Kriteri më i përshtatshëm, sipas mendimit tonë, është ai që mbështetet në temat e foljevet. Në këtë rast, është fjala për një kriter të ndryshëm nga ai që zbatohet tradicionalisht për klasifikimin e emrave në lakime, ku zakonisht⁴ nuk merret parasysh tema e emrit, por nyja shquese e rasës emërore njëjës, pasi klasifikimi sipas tingullit e tingujvet fundorë nuk është aspak praktik.⁵

Përkundrazi, për klasifikimin e foljevet në zgjedhime e nënzhgjedhime nuk mjafton të mbështeturit në morfemat, që s'bëjnë pjesë në temë, d.m.th. në mbaresat vetore të një a më shumë formave kohore. Zbatimi

4) Më ndonjë gramatikë, si p.sh. në atë të Sami Frashërit, janë bërë përpjekje për t'i dalluar tipat e lakimit të emrave edhe sipas tingullit fundor të temës.

5) Shih Sh. Demiraj, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe* (dispensë), pj. I, 27.

I një kriteri të tillë do të na shërbente vetëm për klasifikimin e foljevet të rregullta në dy zgjedhime, por nuk do të na jepte dorë aspak për klasifikimin e mëtejshëm në nënzigjedhime e klasa. Në këtë rast do të ndjehej nevoja edhe për një kriter të dytë, që do të mbështetej në alternimet tingullore të temavet.

4) Për klasifikimin e foljevet në zgjedhime duhet të mbështetemi në tingullin fundor (përkatësisht tingujt fundorë, kur këta janë togje zanoresh) të temavet të kohës së tashme të mënyrës dëftore në diatezën veprorë. Për të gjetur temën, do të mbështetemi kryesisht në formën e vetës së parë njëjës (më ndonjë rast edhe në atë të vetës së dytë njëjës) të së tashmes, pasi në këtë formë, që është një nga më të përdorurat, tema e foljes mund të veçohet relativisht lehtë në shqipen e sotme letrare.

Të mbështeturit në formën e paskajores së tipit *me punue* ose në të ashtuquajturën paskajore të tipit *punuar*, siç bëjnë Samiu dhe Tasi, nuk na duket me vend për këto arësye:

a) Paskajoren e tipit *me punue* e ka vetëm gegërishtja.

b) Format e tipit *punue*, *punua-r*, *la la-rë*, *hap-ë hap-ur*, *godit-ë godit-ur* në shqipen e sotme⁶ nuk kanë vlerën e paskajores, por atë të pjesores së shkuar pësore.

c) Larmia e formavet të pjesores së shkuar pësore në të dy dialektet e shqipes (si rrjedhim i evolucionevet fonetike dhe i veprimt të analogjisë) dhe mundësia shumë e kufizuar e kësaj pjesoreje për t'u përdorur si gjymtyrë më vete e fjalisë, nuk na lejojnë që ta vëmë atë në bazë të klasifikimit të foljevet në zgjedhime.

5) Për ndarjen e mëtejshme të zgjedhimevet në nënzigjedhime e klasa duhet të mbështetemi jo vetëm në temën e kohës së tashme, por edhe në atë të së kryerës së thjeshtë e në disa raste edhe në atë të pjesores.

6) Për renditjen e zgjedhimevet të ndryshme dhe të klasavet përkatëse duhet marrë parasysh sasia numerike e foljevet, që ato ngërthejnë, si edhe shkalla e prodhimitarisë (produktivitetit) së tyre në shqipen e sotme.

III

Në bazë të kriterit të shtjelluar në pikat II/3, 4, 5, foljet e rregullta të shqipes së sotme mund të ndahen në tre ose dy zgjedhime. Në rast se foljet e tipit *mat*, *rrit* etj. do të përdoren pa alternimin bashkëtingëllor s/t (*mas/mat*, *rris/rrit*), atëhere zgjedhimi III mund të mënjanohet.⁷ Por, në rast se do të mbështetemi në përdorimin më të përgjithshëm, që është vënë në themel të Rregullavet të drejtshkrimit të shqipes⁸, d.m.th. në rast se do të ruhet alternimi s/t tek foljet e lartpërmendura, atëhere, sipas mendimit tonë është më mirë të mbahen tre zgjedhime për këto arësye:

a) Alternimi i tingullit fundor s/t të temës dallon foljet e tipit *mas/mat* nga foljet e tipit *hap/hap*.

6) Sipas nesh, as në planin diakronik këto forma nuk kanë qenë të paskajores, por të pjesores së perfektit pësor.

7) Në Rregullat e drejtshkrimit të shqipes (projekt) Tiranë, 1967, nuk është mbajtur qëndrim për këtë, por në C III § 6, 2 rekomandohet varianti *matte*, megjithëse lejohet edhe varianti *maste*. Megjithatë, mbeten nja 20 folje të tipit *përkas/përket*, *vras/vret*, *shes/shet*, në të cilat alternimi bashkëtingëllor është i pashmangshëm. Por vetëm për 20 folje nuk mund të përligjet mbajtja e një zgjedhimi më vete.

8) Shih Rregullat e drejtshkrimit të shqipes (projekt), Tiranë, 1967, f. 7.

2) Po të grupohen të gjitha foljet me temë në bashkëtingëllore në një zgjedhim të vetëm, në zgjedhimin II, ky do të dilte i ngarkuar me shumë klasa e nënklasa, gjë që do ta bënte të vështirë në praktikë.

* * *

Këtu po parashtrijmë për diskutim 2 variante, me përkatësisht tre dhe dy zgjedhime

—A—

Varianti i parë (me tre zgjedhime)

Në zgjedhimin I do të përfshihen foljet me temë në zanore ose tog zanoresh, si *puno-j, rrëfe-j, shkrua-j, lye-j* etj.

Në zgjedhimin II do të përfshihen foljet me temë në çdo bashkëtingëllore përveç foljevet të tipit *mas/mat, shkas/shket*, që alternojnë tingullin fundor *-s/-t*.

Në zgjedhimin III do të përfshihen foljet e tipit *mas/mat, shkas/shket*, që alternojnë tingullin fundor *-s/-t*.

Zgjedhimi I

Zgjedhimi I do të ndahet në tre klasa:

Klasa I

Kjo klasë do të përfshijë foljet, që në dy vetat e para njëjës të së kryerës së thjeshtë marrin tingullin antihiatizues *-v-* midis temës dhe mbaresës vetore.

Kjo klasë do të ndahet në 2 nënklasa:

Nënklasa 1 do të përfshijë:

a) Foljet me temë në zanore (*-o-*, ose *-e-*), që në shumësin e së kryerës së thjeshtë si edhe në pjesore e zbërthejnë zanoren fundore të temës në një tog zanoresh (*-ua-*, *-ye-*), si:

puno-j	puno-v-a/punua-m	punua-r
rrëfe-j	rrëfe-v-a/rrëfye-m	rrëfye-r

b) Foljet me temë në tog zanoresh (*-ua-*, *-ye-*), që në njëjës in e së kryerës së thjeshtë e monoftongojnë atë (në *-o-*, *-e-*), si:

shkrua-j	shkro-v-a/shkrua-m	shkrua-r
lye-j	le-v-a /lye-m	lye-r

Nënklasa 2 do të përfshijë ato folje me temë në zanore, që nuk e zbërthejnë këtë në tog zanoresh as në të kryerën e thjeshtë as në pjesore, si:

la-j	la-v-a/la-më	la-rë
fshi-j	fshi-v-a/fshi-më	fshi-rë

Shënim. — Në këtë nënklasë do të hyjë edhe folja *ble-j*, e cila në vetën e dytë shumës të së tashmes së mënyrës dëftore si edhe në të pakryerën e në urdhërore e alternon zanoren *-e-* në *-i-*.

Klasa II

Kjo klasë do të përfshijë ato folje, që në të kryerën e thjeshtë dhe në pjesore e zgjerojnë temën me afiksin *-t-* ose *-jt-*, si

gje-j	gjet-a	gjet-ur
mba-j	mbajt-a	mbajt-ur
bre-j	brejt-a	brejt-ur
hua-j	huajt-a	huajt-ur

Shënim. — Në këtë klasë do të përfshihen edhe foljet *ngre* dhe *fle*, që në të kryerën e thjeshtë dhe në pjesore e zgjerojnë temën me afiksin *-t-*, por që në vetën e dytë shumës të së tashmes dëftore (si edhe në urdhërore dhe në të pakryerën) pësojnë alternimin vokalik e/i; folja *ngre* e pëson këtë alternim edhe në të kryerën e thjeshtë:

ngre	ngri-ni	ngri-ja	ngrit-a	ngrit-ur
fle	fli-ni	fli-ja	fjet-a	fjet-ur

Klasa III

Kjo klasë do të përfshijë ato folje, që në të kryerën e thjeshtë e zgjerojnë temën me *-r-* (geg. *-n-*).

Kjo klasë do të ndahet në dy nënklasa:

Nënklasa 1 do të përfshijë foljet, që nuk e ndryshojnë zanoren e temës në të kryerën e thjeshtë, si:

bë-j	bër-a	bër-ë
hy-j	hyr-a	hyr-ë

Nënklasa 2 do të përfshijë foljet, që në të kryerën e thjeshtë pësojnë alternimin vokalik *-ë/-u-*, si:

vë	vur-a	vë-në
zë	zur-a	zë-në
përzë	përzur-a	përzë-në
nxë	nxur-a	nxë-në

Zgjedhimi II

Zgjedhimi II do të ndahet në dy klasa:

Klasa I

Kjo klasë do të përfshijë ato folje, që dalin me të njëjtën temë në të tashmen, në të kryerën e thjeshtë dhe në pjesore, si:

hap	hap-a	hap-ur
vendos	vendos-a	vendos-ur

Shënim. — Në këtë klasë do të futen edhe foljet e tipit *ik-i/ik-ën*, *hip-i/hip-ën*, që në tri vetat e njëjësit të së tashmes dëftore (ndryshe nga foljet e tipit *hap/hap*) marrin mbaresat vetore *-i*, *-ën*, *-ën*.

Klasa II

Kjo klasë do të përfshijë foljet, që në të kryerën e thjeshtë pësojnë apofoninë -e/-o- ose -je/-o- dhe -a/-o-, si:

a) heq	hoq-a	heq-ur
dredh	drodh-a	dredh-ur
b) vjel	vol-a	vjel-ë
nxjerr	nxor-a	nxjerr-ë

Shënim. — Këtu do të përfshihen edhe foljet *pjek* dhe *djeg*, të cilat në të kryerën e thjeshtë (dhe në v. II të së tashmes si edhe në të pakryerën e në urdhërore e palatalizojnë tingullin fundor të temës (k > q; g > gj).

c) dal	dol-a	dal-ë
marr	mor-a	marr-ë

Shënimi 1. — Foljet e tipit *heq* dhe *vjel* pësojnë edhe alternimin vokalik -e/-i ose -je/-i- në vetën e dytë shumë të së tashmes si edhe në të pakryerën dhe në urdhërore. Folja *dal* përveç këtij alternimi pëson edhe alternimin -a/-e- në vetën e dytë e të tretë njëjës të së tashmes dëftore. Kurse folja *marr* në të gjitha rastet e lartpërmendura pëson alternimin -a/-e-.

Shënimi 2. — Në këtë klasë mund të përfshihet edhe folja *njoh*, e cila pëson alternimin -o/-e- në vetën e dytë e të tretë njëjës të së tashmes dëftore dhe alternimin -e/-i- në të gjitha rastet e përmendura në shën. 1.

Zgjedhimi III

Zgjedhimi III do të ndahet në 2 klasa:

Klasa I

Kjo klasë do të përfshijë foljet, që nuk e ndryshojnë zanoren e theksuar të temës as në të tashmen as në të kryerën e thjeshtë, si:

mas/mat	mat-a	mat-ur
rris/rrit	rrit-a	rrit-ur

Klasa II

Kjo klasë do të përfshijë ato folje, që e ndryshojnë zanoren e theksuar të temës në të tashmen ose në të kryerën e thjeshtë, ose në të dyja këto kohë.

Kjo klasë do të ndahet në 3 nënklasa:

Nënklasa 1 do të përfshijë foljet me temë të zgjeruar të tipit *përkas*, që në të tashmen pësojnë metafoninë a:e në vetën e dytë e të tretë njëjës (dhe alternimin vokalik e:i në vetën e dytë shumë të së tashmes) dhe që në të kryerën e thjeshtë dalin ose me temë të pazgjeruar ose edhe me temën e zgjeruar të së tashmes duke pësuar alternimin vokalik e:i, p.sh.

përkas/përket/përkit-ni, prek-a dhe përkit-a, prek-ur
 kërcas/kërcet/kërcit-ni, kris-a dhe kërcit-a, kris-ur
 thërras/thërret/thërrit-ni, thirr-a dhe thërrit-a, thirr-ur

pëllas/pëllet/pëllit-ni, pall-a dhe pëllit-a, pall-ur
 këlthas/këlthet/këlthit-ni, klith-a, klith-ur
 pëlças/pëlçet/pëlçit-ni, plas-a, plas-ur
 flas/flet/flit-ni, fol-a, fol-ur

Nënklasa 2 do të përfshijë foljet *shes*, *pres* (prit-a), *zbres*, të cilat në të kryerën e thjeshtë dhe në vetën e dytë shumës të së tashmes si edhe në të pakryerën e në urdhërore pësojnë alternimin vokalik *e:i*. P.sh.:

shes/shet/shit-ni, shit-a, shit-ur
 pres/pre/prit-ni, prit-a; prit-ur
 zbres/zbret/ zbrit-ni, zbrit-a, zbrit-ur

Nënklasa 3 do të përfshijë foljet *shkas*, *vras*, *ngas* dhe *gërgas* të cilat pësojnë alternimin vokalik *a:e* në vetën e dytë e të tretë njëjës dhe alternimin vokalik *e: i* në vetën e dytë shumës të së tashmes (si edhe në të pakryerën e në urdhërore), ndërsa në të kryerën e thjeshtë nuk e kanë tingullin fundor të temës së kohës së tashme. Në të kryerën e thjeshtë dhe në pjesore këto folje dalin me forma të ngjashme me ato të zgjedhimit I (klasa I, nënklasa 2). P.sh.:

shkas/shket/shkit-ni, shka-v-a, shka-rë
 vras/vret/vrit-ni, vra-v-a, vra-rë
 ngas/nget/ngit-ni, nga-v-a, nga-rë

Shënim. — Në këtë nënklasë do të përfshihet edhe folja *pres* (*pre-v-a*), e cila në vetën e dytë shumës pëson alternimin vokalik *e: i* dhe në të kryerën e thjeshtë dhe në pjesore del me forma të ngjashme me ato të foljevet të nënklasës 4:

pres/pre/prit-ni, pre-v-a, pre-rë

Foljet e parregullta

Këto do të ndahen në dy grupe. Në grupin e parë do të futen foljet supletive, kurse në grupin e dytë do të futen foljet e parregullta jo-supletive.

A) Folje supletive

1) ap	dhashë	dhë-në
2) bie	prur-a	prur-ë
3) bie	ra-shë	rë-në
4) ha	hëngr-a	ngrë-në
5) jam	qe-shë	qe-në
6) kam	pat-a	pat-ur a pas-ur
7) rri	ndenj-a	ndenj-ur
8) shoh	pa-shë	pa-rë
9) vij	erdh-a	ardh-ur

B) Foljet e parregullta jo-supletive

1) dua	desh-a	dash-ur
2) lë	la-shë	lë-në
3) shpie	shpur-a	shpur-ë
4) shtie	shti-v-a (a shtur-a)	shtë-në (a shtur-ë).

5) thom	tha-shë	thë-në
6) vdes	vdiq-a	vdek-ur
7) vete	vajt-a	vajt-ur

—B—

Varianti i dytë (me dy zgjedhime)

Siç u vu në dukje edhe më sipër, në rast se foljet e tipit *mat, rrit* do të përdoren pa alternimin bashkëtingëllor s/t (*mas/mat, rris/rrit*), atëhere foljet e rregullta të shqipes mund të ndahen në dy zgjedhime.

Në zgjedhimin e parë do të përfshihen foljet me temë në zanore, ose tog zanoresh, si puno-j, shkrua-j etj.

Në zgjedhimin e dytë do të përfshihen foljet me temë në bashkëtingëllore, si *hap, mat* etj.

Zgjedhimi I

Si në variantin e parë me tre zgjedhime.

Zgjedhimi II

Zgjedhimi II do të ndahet në dy klasa.

Klasa I

Kjo klasë do të përfshijë ato folje, që dalin me të njëjtën temë në të tashmen, në të kryerën e thjeshtë dhe në pjesore, si:

hap	hap-a	hap-ur
vendos	vendos-a	vendos-ur
mat	mat-a	mat-ur

Shënim. — Në këtë klasë do të futen edhe foljet e tipit *ik-i/ik-ën, hip-i/hip-ën*, që në tri vetat e njëjësit të së tashmes dëftore (ndryshe nga foljet e tipit *hap/hap, mat/mat*) marrin mbaresat vetore *-i, -ën, -ën*.

Klasa II

Në këtë klasë do të përfshihen foljet, që pësojnë alternime vokalike në të tashmen ose në të kryerën e thjeshtë, ose në të dyja këto kohë.

Kjo klasë do të ndahet në katër nënklasa.

Nënklasa I do të përfshijë foljet, që në të kryerën e thjeshtë pësojnë apofoninë *-e/-o-* ose *-je/-o-* dhe *-a/-o-*, si:

a) heq	hoq-a	heq-ur
dredh	drodh-a	dredh-ur
b) vjel	vol-a	vjel-ë
nxjerr	nxor-a	nxjerr-ë

Shënim. — Këtu do të përfshihen edhe foljet *pjek* dhe *djeg*, të cilat në të kryerën e thjeshtë e palatalizojnë tingullin fundor të temës (*k > q, g > gj*).

c) dal	dol-a	dal-ë
marr	mor-a	marr-ë

Shënim. — Në këtë nënklasë mund të përfshihet edhe folja *njoh*, e cila pëson alternimin -o/-e- në vetën e dytë e të tretë njëjës të së tashmes dëftore dhe alternimin -e/-i- në të gjitha rastet e përmendura në shën. 1 të klasës II të zgjedhimit II të variantit I (me tre zgjedhime).

Nënklasa 2 do të përfshijë foljet me temë të zgjeruar të tipit *përkas*, që në të tashmen pësojnë alternimin vokalik *a:e* në vetën e dytë e të tretë njëjës (dhe alternimin vokalik *e: i* në vetën e dytë shumë) dhe që në të kryerën e thjeshtë dalin ose me temë të pazgjeruar ose edhe me temën e zgjeruar të së tashmes duke pësuar alternimin vokalik *e:i*. P.sh.

përkas/përket/përkit-ni, prek-a dhe përkit-a, prek-ur
 kërcas/kërcet/kërcit-ni, kris-a dhe kërcit-a, kris-ur
 thërras/thërret/thërrit-ni, thirr-a dhe thërrit-a, thirrur.
 pëllas/pëllet/pëllit-ni, pall-a dhe pëllit-a, pall-ur
 këlthas/këlthet/këlthit-ni, klith-a, klith-ur
 flas/flet/flit-ni, fol-a, fol-ur

Nënklasa 3 do të përfshijë foljet *shes*, *pres* (*prit-a*), *zbres*, të cilat në të kryerën e thjeshtë dhe në vetën e dytë shumë të së tashmes pësojnë alternimin vokalik *e: i*. P.sh.

shes/shet/shit-ni, shit-a, shitur
 pres/pre/prit-ni, prit-a, prit-ur
 zbres/zbret/zbrit-ni, zbrit-a, zbrit-ur

Nënklasa 4 do të përfshijë foljet *shkas*, *vras*, *ngas* dhe *gërgas*, të cilat pësojnë alternimin vokalik *a: e* në vetën e dytë e të tretë njëjës dhe alternimin vokalik *e: i* në vetën e dytë shumë të së tashmes, ndërsa në të kryerën e thjeshtë nuk e kanë tingullin fundor të temës së kohës së tashme. Në të kryerën e thjeshtë këto folje dalin me forma të ngjashme me ato të zgjedhimit I (klasa I, nënklasa 2). P.sh.

shkas/shket/shkit-ni, shka-v-a, shka-rë
 vras/vret/vrit-ni, vra-v-a, vra-rë
 ngas/nget/ngit-ni, nga-v-a, nga-rë

Shënim. — Në këtë nënklasë do të përfshihet edhe folja *pres* (*pre-v-a*) e cila në vetën e dytë shumë pëson alternimin vokalik *e: i* dhe në të kryerën e thjeshtë del me forma të ngjashme me ato të foljeve të nënklasës 4: *pres/pre/prit-ni*, *pre-v-a*, *pre-rë*.

Foljet e parregullta

Si në variantin e parë (me tre zgjedhime).

